



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:241479

Datë: 02.10.2024

Numri i dokumentit: 06240175

C.nr.554/2019

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË- DEGA NE VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Leotrim Gashi, në procedurën kontestimore sipas padisë së paditësit H.H., me vendbanim Komuna e Vushtrrisë, të cilin me autorizim e përfaqëson B.H., avokat me seli në Vushtrri, kundër të paditurit S.M., me vendbanim rr.” Adem Jashari”, Komuna e Vushtrrisë, të cilin me autorizim e përfaqëson N.B. avokat me seli në Vushtrri, me objekt kontesti lirim i pronës, jashtë seancës, më datë 02.10.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET e tërhequr padia C.nr.554/2019, e datës 05.08.2019, e paditësit H.H., ndaj të paditurit S.M. me objekt kontesti lirim i pronës.

A r s y e t i m

Paditësi H.H., me datë 05.08.2019, përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar av. B.H., ka paraqitur në këtë gjykatë padinë ndaj të paditurit S.M., për lirimimin e podrumit.

Gjykata me datë 09.07.2024, ka marr aktvendim me të cilin e ka detyruar të paditurin që ta paraqes përgjigjen në padi, i padituri S.M., me datë 15.07.2024, përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar av. N. B., ka paraqitur në gjykatë përgjigjen në padi.

Gjykata me datë 08.08.2024 kishte caktuar seancën përgatitore, në të cilën i padituri kishte deklaruar se podrumin kontestues e kishte shitur te blerësi Z. I. për çka kishte edhe kontratë, në atë seancë gjykata e kishte detyruar të paditurin që t'ia dorëzoj gjykatës kontratën e theksuar nga i njëjti, të cilin obligim i padituri e kishte përmbushur me datë 09.08.2024.

Me datë 30.08.2024 gjykata kishte kërkuar nga Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë e Komunës së Vushtrrisë që t'ia dorëzoj gjykatës historiatin e pronës kontestuese, të cilës kërkesë Komuna i ishte përgjigjur me datë 03.09.2024

Në seancën e vazhdimit të seancës përgatitore, të datës 24.09.2024, përfaqësuesi i paditësit ka deklaruar se pas konsultimit me paditësin, e tërheq padinë ndaj të paditurit, me arsyetimin se i njëjti e ka shitur lokalin kontestues blerësit Z. I. dhe i padituri nuk e posedon lokalin kontestues dhe se do të paraqesin padi të re ndaj Z. I.

Në anën tjetër përfaqësuesi i të padituri deklaroi se pajtohet që padia e paditësit të konstatohet e tërhequr

Andaj gjykata, duke u bazuar në nenin 261 par 1. të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ku thuhet se *“Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi”*, e po ashtu paragrafit 2 të këtij neni sipas të cilit theksohet se *“Padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë”* dhe me paragrafin 3 të këtij neni ku thuhet se *“Po që se padia është tërhequr, gjykata jep aktvendim me të cilin konstatohet se është tërhequr padia. Ky aktvendim i dërgohet të paditurit vetëm po që se padia i është dorëzuar me parë”*, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi sepse janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore që të mirret vendimi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga të lartcekurat, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2019:241479, C.nr.554/2019, me datë 02.10.2024**

G j y q t a r i

Leotrim Gashi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi në bazë të nenit 261 par 4, të LPK-së nuk është e lejuar ankesa.